



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 06 Nr. 34982  
U. \_\_\_\_\_ Br. \_\_\_\_\_

Nr. i faq. 1 Data: 05/11  
Br. str. \_\_\_\_\_ Datum: 2024

KAMENICËJA  
**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMUNA E KAMENICËS**  
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Në bazë të nenit 3 , paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenit 4 , paragrafi 3, pika 3.1 , nenit 5, nenit 6, nenit 7, nenit 8. nenit 10, nenit 11, nenit 12, nenit 13 dhe nenit 14 të **Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/ 2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Kamenicës** organizon:

### SHQYRTIM PUBLIK

**Për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës, grupet e interesit dhe palët e interesuara për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës për vitet 2024-2032**

Ky dokument do të jetë në shqyrtim publik nga data **14.11.2024** deri më datën: **14.12.2024**, ndërsa prezantimi-konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **14.11.2024**, në sallën mbledhjeve të Kuvendit Komunal (me fillim nga ora 16:00).

Pjesa grafike e PZHKsë, në formatin letër, do të mbahet e ekspozuar gjatë kësaj periudhe 30 ditore në shtëpinë e kulturës (salla e bibliotekës së qytetit), ndërsa komentet dhe sugjerimet lidhur me dokumentin në fjalë mund t'i dërgoni deri më datë **14.12.2024** në e-mailin: [uran.berisha@rks-gov.net](mailto:uran.berisha@rks-gov.net)

Për më shumë detaje për **Projekt - Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenicës për vitet 2024-2032**, mund t'i vizitoni vegzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/kamenice/category/konsultime-publike/>

Facebook-un zyrtar:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/>

Uran Berisha

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizim dhe Planifikim Hapësinor



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture  
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.09.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Uran Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor - Komuna e Kamenicës
CC:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	<b>Vendim për pëlqim</b> për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit "Plani Zhvillimor i Komunës së Kamenicës 2024-2032"

I nderuar z. Berisha,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor nenit 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.1) Komuna e Kamenicës ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 09.09.2024 me numër të protokollit 4633-2/24, kërkesën "për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit "Plani Zhvillimor i Komunës së Kamenicës 2024-2032".

Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projektit "Plani Zhvillimor i Komunës së Kamenicës 2024-2032" me "Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Kamenicës sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoritetit Komunal për Planifikimit dhe Menaxhim Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
Kryetari i Komunitetit



\_\_\_\_\_  
Kryetari i Komunitetit